

# KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË PIKAVE TË AKSESIT PA TEL NË ZONA TË VOGLA

## Neni 1 Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky dokument përcakton karakteristikat teknike dhe fizike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla.
2. Përcaktimet sipas këtij dokumenti nuk zbatohen për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla për një sistem antenash aktive.

## Neni 2 Përkufizime

Në këtë dokument, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Fuqia rrezatuese izotropike ekuivalente" ose EIRP, nënkupton produktin e fuqisë së furnizuar në antenë dhe përforcimi i antenës në një drejtim të caktuar në lidhje me një antenë izotropike (përforcimi absolut ose izotropik);
2. "Sistem antenash" nënkupton një pjesë "*hardware*" të një pike aksesit pa tel në zona të vogla që rrezaton energji të radiofrekuencave me qëllim ofrimin e lidhjes pa tel të përdoruesit fundor;
3. "Sistemi i antenës aktive" ose AAS, nënkupton një sistem antenash ku amplituda ose faza, ose të dyja, midis elementëve të antenës rregullohen vazhdimisht duke rezultuar në një model antenash që ndryshon në përgjigje të ndryshimeve afatshkurtra në një mjedis radio, duke përjashtuar formimin afatgjatë të rrezes me anim elektrik fiks për poshtë, në një pikë të aksesit pa tel në zona të vogla e pajisur me një AAS. Kjo e fundit është e integruar si pjesë e pikës së aksesit pa tel në zona të vogla;
4. "I brendshëm" ose "*Indoor*" nënkupton çdo hapësirë, përfshirë dhe mjetet e transportit, që kanë një strukturë të fiksuar ose të lëvizshme, tavan ose çati, ose ndonjë pajisje që është në gjendje të mbulojë të gjithë hapësirën, dhe që përveç dyerve, dritareve dhe vendkalimeve, është tërësisht e mbyllur me mure ose anë, në mënyrë të përhershme ose të përkohshme, pavarësisht nga lloji i materialit të përdorur për çatine, muret ose anët;
5. "Jashtë" ose "*Outdoor*" nënkupton çdo hapësirë që nuk është e brendshme;

## Neni 3 Karakteristikat teknike dhe fizike

1. Në zbatim të nenit 78, të ligjit Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", pikat e aksesit pa tela në zona të vogla, duhet të përmbushin kërkesat e standardeve të përshkruara në nenin 5, të këtij dokumenti dhe:
  - a) Të jenë të sigurt, plotësisht të integruara në strukturën e tyre mbështetëse dhe të padukshme për publikun e gjerë; ose
  - b) Të plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4 të këtij dokumenti;
2. Kërkesat e përcaktuara sipas paragrafit 1, nuk pengojnë përcaktimin dhe zbatimin e niveleve të përgjithshme për fushat elektromagnetike në rastet e bashkëvendosjes ose grumbullimit, të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla në një zonë lokale.

3. Pikat e aksesit pa tel në zona të vogla, duhet të sigurojnë respektimin e kufijve të zbatueshëm për ekspozimin e fushave elektromagnetike në përputhje me legjislacionin në fuqi, përveç lejeve individuale që lidhen me vendosjen e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla.
4. Operatorët që kanë vendosur pika aksesit pa tel në zona të vogla me fuqi deri në 2 Wat, ose 10 Wat, në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, njoftojnë AKEP brenda dy javësh nga vendosja e këtyre pikave të aksesit duke njoftuar për datën e instalimit, vendndodhjen e tyre si dhe kërkesat teknike që plotësojnë sipas këtij neni.

#### Neni 4

#### Kushtet fizike për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla

1. Në zbatim të shkronjës b, pikës 1, të nenit 3, pikat e aksesit pa tel në zona të vogla duhet të përmbushin kushtet fizike si më poshtë:
  - a) Vëllimi i përgjithshëm i pjesës së dukshme për publikun e gjerë të një pike aksesit pa tel në zona të vogla që shërben për një ose më shumë përdorues të spektrit radio nuk duhet të kaloj 30 litra.
  - b) Vëllimi i përgjithshëm i pjesëve të dukshme për publikun e gjerë të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla të shumëfishta të ndara duke përdorur të njëjtin infrastrukturë të stacionit për një sipërfaqeje individuale të kufizuar, si p.sh. një shtyllë drite, një semafor, një tabelë reklamuese ose një stacion autobusi, nuk duhet të kaloj 30 litra.
  - c) Në rastet kur sistemi i antenës dhe elementë të tjerë, si: një njësi radiofrekuence, një procesor digjital, një njësi ruajtëse, një sistem ftohjeje, një furnizues energjie elektrike, lidhjet kabllore, elementë të pasme ose elementë për tokëzim dhe fiksime, të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla janë instaluar veçmas, çdo pjesë e saj që tejkalon 30 litra duhet të jetë e padukshme për publikun e gjerë.
  - d) Pika e aksesit pa tel në zona të vogla duhet të ketë konsistencë vizuale me strukturën mbështetëse dhe të ketë një madhësi proporcionale në lidhje me madhësinë e përgjithshme të strukturës mbështetëse, formë të qëndrueshme, ngjyra neutrale që përputhen ose përziehen me strukturën mbështetëse dhe kabllot e fshehura dhe nuk duhet, së bashku me pikat e tjera në zona të vogla pa tel që janë instaluar tashmë në të njëjtin stacion ose në stacionet ngjitur, të krijojnë një pamje të përgjithshme të çrregullt.
  - e) Pësha e një pike aksesit pa tel në zona të vogla dhe forma e saj nuk duhet të imponojnë një përforsim strukturor të strukturë mbështetëse.
  - f) Një pikë aksesit pa tel në zona të vogla të klasës së instalimit E10 (10 WAT) do të vendoset vetëm në ambiente të jashtme ose në hapësira të mëdha të brendshme, të cilat kanë lartësi tavanit të paktën 4 m.

#### Neni 5

#### Kërkesat për zbatimin e standardeve

1. Vendosja e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla duhet të jetë në përputhje me klasat e instalimit E0, E2 dhe E10 të përcaktuar në tabelën e seksionit 6.2.4 të standardit SSH EN 62232:2017, për përcaktimin e fuqisë së fushës së radiofrekencave, densitetit të fuqisë dhe SAR, në afërsi të stacioneve bazë të radiokomunikacionit për qëllim të vlerësimit të ekspozimit të njeriut.
2. Në rastin e sistemeve të shumëfishta të antenave të bashkëvendosura (ose pjesëve të tyre) të një ose më shumë pikave të aksesit pa tel në zona të vogla subjekt i kësaj rregulloreje,

kriteret për EIRP të përfshira në standardin e përmendur në pikën 1 do të zbatohen për totalin e EIRP-it për të gjitha sistemet e antenave të bashkëvendosura (ose pjesëve të tyre).

### **Neni 6 Raportimi**

AKEP monitoron rregullisht zbatimin e këtyre kërkesave dhe përgatit një raport çdo vit për zbatimin e këtij dokumenti, në veçanti për zbatimin e pikës 1, të nenit 3, duke përfshirë teknologjitë e përdorura nga vendosja e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla i cili publikohet në faqen e AKEP.

**RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN  
"PËR MIRATIMIN E E KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË PIKAVE TË  
AKSESIT PA TEL NË ZONA TË VOGLA"**

**I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË  
ARRIHEN**

Projektakti "Për miratimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla", është propozim i Ministrisë për Infrastrukturën dhe Energjinë, në përputhje me nenin 78 të ligjit Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", dhe synon plotësimin e kuadrit nënligjor që del i nevojshëm me miratimin e ligjit të ri për komunikimet elektronike.

Ky projektvendim ka për qëllim të miratojë karakteristikat teknike dhe fizike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla për të cilat ligji ka parashikuar disa rregullime në nenin 78 të tij.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK  
TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2023-2025 dhe në Planin Analitik të akteve për vitin 2024, dhe lidhet me zbatimin e ligjit të ri për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,  
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i cili ka transpozuar Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike", në nenin 78, ka parashikuar rregulla për vendosjen dhe funksionimin e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla si dhe miratimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Projektvendimi "Për miratimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla" synon të plotësojë aktet nënligjore të parashikuara në ligjin Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" në përputhje me praktikën e BE-së për këtë qëllim.

Me anë të këtij projektvendimi synohet transpozimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (EU) 2020/1070, e datës 20 Korrik 2020, mbi specifikimin e karakteristikave të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla në përputhje me paragrafin 2, të nenit 57, të Direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike.

**IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE  
HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI VENDAS E  
NDËRKOMBËTAR**

Ky projektakt është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe në mbështetje të nenit 78 për "Vendosjen dhe funksionimin e pikave

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla"

të aksesit pa tel në zona të vogla", të ligjit Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTVENDIMET NORMATIVE)**

Projektvendimi transponon plotësisht, Rregullorren Implementuese të Komisionit (EU) 2020/1070, e datës 20 Korrik 2020 mbi specifikimin e karakteristikave të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla në përputhje me paragrafin 2, të nenit 57, të Direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike.

Bazuar në nenin 70 dhe 104 të MSA-së, Shqipëria ka detyrimin e përafrimit të legjislacionit të BE-së, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

## **VI. PËRMbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit**

Projektakti përmban dy nene ku me nenin 1, miraton dokumentin që përcakton karakteristikat teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla dhe me nenin 2, përcakton autoritetet përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tij.

Dokumenti i bashkëlidhur projektvendimit që përcakton karakteristikat teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla është i organizuar në 6 nene si më poshtë:

- Në nenin 1, paraqitet objekti dhe fusha e zbatimit të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla të përmendura në nenit 78 për "Vendosjen dhe funksionimin e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla" të ligjit Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu përcaktohet se këto karakteristika nuk zbatohen për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla me një sistem antenash aktive. Ky nen është në përputhje të plotë me nenin 1, të Rregullores së (BE) 2020/1070.
- Në nenin 2, jepen përkufizimet në përputhje të plotë me përcaktimet në rregulloren e BE-së.
- Në nenin 3, paraqiten karakteristikat teknike dhe fizike që duhet të kenë pikat e aksesit pa tela në zona të vogla të cilat plotësohen me kërkesat e nenit 4 dhe 5, të cilat kane transpozuar Aneksin e Rregullores së BE-së.
- Në nenin 4, paraqiten kushtet fizike për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla që duhet të jenë parasysh e në vijim të karakteristikave teknike dhe fizike të përmendura në nenin 3. Parashikimet e këtij neni janë në harmoni të plotë me Pjesën A, të aneksit të Rregullores së (BE) 2020/1070.
- Në nenin 5, paraqiten kërkesat për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla të cilat duhet të jenë në përputhje me standardin e harmonizuar shqiptar me atë evropian.
- Në nenin 6, përcaktohet AKEP si autoriteti që do monitorojë rregullisht zbatimin e kërkesave të përcaktuara në këtë dokument. Njëkohesist është parashikuar që të përgatitet dhe një raport vjetor për zbatimin e këtij dokumenti i cili publikohet.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ky projektvendim parashikon Ministrin për Infrastrukturën dhe Energjinë dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare si organi rregullator, mbikqyrës i sektorit të komunikimeve elektronike si dy institucionet që do ndjekin zbatimin e këtij projekt akti.

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla"

**VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË  
HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar nga strukturat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ka përafuar Rregulloren 2020/1070/EU "Për specifikimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla".

**IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE  
BUXHETORE**

Projektvendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**DHE**

**MINISTËR**

**Belinda Balluku**

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e karakteristikave teknike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla"

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

<p>Regjutoria Implementuese e Komisionit (EE) 2020/1070 e datës 20 Korrik 2020 mbi specifikimin e karakteristikave të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla në përputhje me paragrafin 2 të nenit 57 të Direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike          C/2020/4872; OJ L 254, 21.7.2020, p. 11-15</p>						
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Neni 1	Neni 1	1	Neni 1	Neni 1 <b>Objekti dhe zbatimi</b> 1. Ky dokument përcakton karakteristikat teknike dhe fizike të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla. 2. Përcaktimet sipas këtij dokumenti nuk zbatohen për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla për një sistem antenash aktive.	E Plotë	
Neni 2	Neni 2		Neni 2	Neni 2 <b>Përkufizime</b> Në këtë dokument, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Fuqia trezuese izotropike ekuivalente" ose EIRP, nënkupton produktin e fuqisë së furnizuar në antenë dhe përforcimin i antenës në një drejtim të caktuar në lidhje me një antenë izotropike (përforcimi absolut ose izotropik); 2. "Sistem antenash" nënkupton një pjesë "hardware" të një pike aksesit pa tel në zonë të qëllim ofrimin e lidhjes pa tel të përdoruesit fundor; 3. "Sistemi i antenës aktive" ose AAS, nënkupton një sistem antenash ku amplituda ose faza, ose të dyja, midis elementeve të antenës rregullohen	E Plotë	

	<p>ndryshon në përgjigje të ndryshmeve afatshkurtra në mjedisin e radios: kjo përfashon formimin afatgjatë të rezes si pjerësi elektrike e fiksuar pothuajse në një pikë aksesi pa tel me zonë të vogël të pajisur me një AAS, kjo e fundit është e integruar si pjesë e pikës së aksesi me valë me zonë të vogël;</p> <p>(4) "1 brendshëm" nënkupton çdo hapësirë, duke përfshirë mjetelet e transportit, që ka një tavan ose çati ose ndonjë strukturë ose pajisje të palvizshme ose të lëvizshme që është në gjendje të mbulojë të gjithë atë hapësirë, dhe përveç detyrë, dritareve dhe rrugëkalimeve, është tërësisht e mbyllur nga muret ose anët, përgjithmonë ose përkohësisht, pavarësisht nga lloji i materialit të përdorur për çati, mur ose anët, dhe pavarësisht nëse struktura është e përbërshme ose e përkohshme;</p> <p>(5) "Jashë" nënkupton çdo hapësirë që nuk është e brendshme.</p>			<p>vazhdimisht duke rezultuar në një model antenash që ndryshon në përgjigje të ndryshmeve afatshkurtra në një mjedis radio, duke përfshirë formimin afatgjatë të rezes me anim elektrik fiks për pothuajse në një pikë të aksesi pa tel në zona të vogla e pajisur me një AAS. Kjo e fundit është e integruar si pjesë e pikës së aksesi pa tel në zona të vogla;</p> <p>4- "1 brendshëm" ose "Indoor" nënkupton çdo hapësirë, përfshirë dhe mjetelet e transportit, që kanë një strukturë të fiksuar ose të lëvizshme, tavan ose çati, ose ndonjë pajisje që është në gjendje të mbulojë të gjithë hapësirën, dhe që përveç detyrë, dritareve dhe vendkalimeve, është tërësisht e mbyllur me mure ose anët, në mënyrë të përbërshme ose të përkohshme, pavarësisht nga lloji i materialit të përdorur për çatinë, murat ose anët;</p> <p>5- "Jashë" ose "Outdoor" nënkupton çdo hapësirë që nuk është e brendshme;</p>		
<p>Neni 3</p>	<p>Neni 3</p> <p>1. Pikat e aksesi pa tela të zonës së vogël të referuara në nenparagrafin e dytë të neni 57(1) të Direktivës (BE) 2018/1972 duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardit evropian të përcaktuar në pikën B të shprehjes së kësaj rregullorjeje dhe ose: (a) të jenë plotësisht dhe të sigurtat të integruara në strukturën e tyre mbështetëse dhe për këtë arsye të padukshme për publikun e gjerë; ose (b) plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën A të aneksit të kësaj rregullorjeje. 2. Paragrafi 1 është pa paragrafkin ndaj kompetencave të Shteteve Anëtare për të përcaktuar nivelin e përgjithshme të fushave elektromagnetike që rezultojnë nga bashkëlokimin ose grumbullimin në një zonë lokale të pikave të aksesi pa tela me një zonë të vogël, dhe për të siguruar përputhjen me agregatit elektronik të aplikueshëm. -Kurfihtë e ekspozimit të fushave magnetike në përputhje me ligjin e Bashkimit me mjete të ndryshme nga lejet individuale që lidhen me vendosjen e pikave të</p>		<p>Neni 3</p>	<p>Neni 3</p> <p><b>Karakteristikat teknike dhe fizike</b></p> <p>1. Në zbatim të neni 78, të ligjit Nr. ____/____ "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", pikat e aksesi pa tela në zona të vogla, duhet të përmbushin kërkesat e standardeve të përshtatshme në nenin 5, të këtij dokumenti dhe:</p> <p>(a) Të jenë të sigurtat, plotësisht të integruara në strukturën e tyre mbështetëse dhe të padukshme për publikun e gjerë; ose</p> <p>(b) Të plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4 të këtij dokumenti;</p> <p>2. Kërkesat e përcaktuara sipas paragrafit 1, nuk pengojnë përcaktimin dhe zbatimin e niveleve të përgjithshme për fushat elektromagnetike në rastet e bashkëvendosjes ose grumbullimit, të pikave të aksesi pa tel në zona të vogla në një zonë lokale.</p> <p>3. Pikat e aksesi pa tel në zona të vogla, duhet të sigurojnë respektimin e kurfihtë të zbatueshëm për ekspozimin e fushave elektromagnetike në përputhje me legjislativonin në fuqi, përveç lejeve</p>	<p>E Plotë</p>	



	aksesit me valë me një zonë të vogël. ENOFletoria Zyrtare e Bashkimit Evropian 21.7.2020 L 234/13 3. Operatorët që kanë vendosur pika aksesit pa tela me zonë të vogël të Klasave E2 ose E10 në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, duhet të njoftojnë autoritetin kompetent kombëtar brenda dy javësh nga vendosja e secilës pike të tilla për instalimin dhe vendndodhjen e tyre pikat e hyrjes si dhe kërkesat që ato plotësojnë në përputhje me atë paragraf.			individuale që lidhen me vendosjen e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla 4. Operatorët që kanë vendosur pika aksesit pa tel në zona të vogla me fuqi deri në 2 Wat ose 10 Wat në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, njoftojnë AKEP brenda dy javësh nga vendosja e këtyre pikave të aksesit duke njoftuar për datën e instalimit, vendndodhjen e tyre si dhe kërkesat teknike që plotësojnë sipas këtij neni.		
<b>Neni 4</b>	<b>Neni 4</b>		<b>Neni 6</b>	<b>Neni 6</b> <b>Raportimi</b>	<b>E Plotë</b>	
	Shtetet Anëtare do të monitorojnë rregullisht dhe do të raportojnë Komisionit, herën e parë deri më 31 dhjetor 2021, dhe çdo vit më pas, për zbatimin e kësaj rregulloreje, në veçanti për zbatimin e nentit 3(1), duke përfshirë teknologjitë e përdorura nga Pikat e aksesit me valë të zonës së vogël të vendosura.			AKEP monitoron rregullisht zbatimin e këtyre kërkesave dhe përgatit një raport çdo vit për zbatimin e këtij dokumenti, në veçanti për zbatimin e pikës 1, të nentit 3, duke përfshirë teknologjitë e përdorura nga vendosja e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla i cili publikohet në faqen e AKEP. E pazbaueshme		
<b>Neni 5</b>	<b>Neni 5</b>					
	Kjo rregullore hyr në fuqi në ditën e njëzetë pas përfundimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Ajo do të zbatohet nga 21 dhjetori 2020. Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësi në saj dhe e zbatueshme drejtpërdrejt në të gjitha Shtetet Anëtare. Bërë në Bruksel, 20 korrik 2020					
<b>ANEXS</b>	<b>A. Kushtet e përmendura në pikën (b) të nentit 3(1)</b> 1. Veprimi i përgjithshëm i pjesës së dukshme për publikum e gjerë të një pike aksesit me valë me zonë të vogël që shërben një ose më shumë përdorues të spektarit të radios nuk duhet të kalojë 30 litra. 2. Veprimi i përgjithshëm i pjesëve të dukshme për publikum e gjerë të pikave të shumta të vegjara të aksesit pa tel me zonë të vogël që ndëgjë të njëjtin vend infrastrukturor të një sipërfaqjeje individuale të kufizuar si shlytja e dritës, një semafor, një tabelë reklamimi ose një stacion autobus, do të jo më shumë se 30 litra. 3. Në rastet kur sistemi i antenës dhe elementë të fletë, si një njësi		<b>Neni 4</b>	<b>Neni 4</b> <b>Kushtet fizike për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla</b>	<b>E Plotë</b>	
<b>Pjesa A</b>				1. Në zbatim të shkronjës b, pikës 1, të nentit 3, pikat e aksesit pa tel në zona të vogla duhet të përmbushin kushtet fizike si më poshtë: a) Veprimi i përgjithshëm i pjesës së dukshme për publikum e gjerë të një pike aksesit pa tel në zona të vogla që shërben për një ose më shumë përdorues të spektarit radio nuk duhet të kalojë 30 litra.		

<p><b>ANEKS</b> Pjesa B</p>	<p>B. Kërkesat e standardit evropian të përmendur në nenin 3(1) 1. Vendosja e pikave të aksesit pa tela me zonë të vogël duhet të jetë në përputhje me klasat e instalimit E0, E2 dhe E10 të tabelës 2 të pikës 6.2.4 të standardit evropian EN 62232:2017 "Percaktimi i fuqisë së fushës RF, densiteti i fuqisë dhe shpërfësia</p>	<p><b>Neni 5</b></p>	<p><b>Kërkesat për zbatimin e standardëve</b></p> <p>1. Vendosja e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla duhet të jetë në përputhje me klasat e instalimit E0, E2 dhe E10 të përcaktuara në</p>	<p>radiofrenkuencash, një procesor dixhital, një njësi ruajtëse, një sistem ftohjeje, furnizim me energji elektrike, lidhje kablore, elementë backhaul ose elementë për tokëzim dhe fiksim, të pikat e aksesit pa tela të zonës janë instaluar veçmas, çdo pjesë e tyre mbi 30 litra duhet të jetë e padukshme për publikun e gjerë. 4. Pika e aksesit pa tela me sipërfaqe të vogël duhet të ketë konsistencë vizuale me strukturën mbështetëse dhe të ketë një madhësi proporcionale në raport me madhësinë e përgjithshme të strukturës mbështetëse, formë koherente, ngjyra neutrale për tu përshatur ose për tu përzier me strukturën mbështetëse dhe kabllo e fshihura, dhe nuk duhet të krijojë rremujë të përgjithshme vizuale, së bashku me pikat e tjera të aksesit me vajt me një zonë të vogël që janë instaluar tashmë në të njëjtin vend ose në faqet ngjitur. 5. Pështa e një pike aksesit me vajt me sipërfaqe të vogël dhe forma e saj nuk duhet të imponojnë një përforcim strukturor të strukturës mbështetëse. 6. Një pikë aksesit me vajt me sipërfaqe të vogël të klasës së instalimit E10 do të vendoset vetëm në hapësira të jashtme ose të brendshme të mëdha, të cilat kanë një lartësi tavanit prej të paktën 4 m.</p>	<p>b) Vëllimi i përgjithshëm i pjesëve të dukshme për publikun e gjerë të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla të shumëfshita të ndara duke përdorur të njëjtin infrastrukturë të stacionit për një sipërfaqeje individuale të kufizuar, si p.sh. një shtyllë drite, një semafor, një tabelë reklamuese ose një stacion autobusi, nuk duhet të kalojë 30 litra.</p> <p>c) Në rastet kur sistemi i antenës dhe elementë të tjerë, si një njësi radiofrenkuence, një procesor dixhital, një njësi ruajtëse, një sistem ftohjeje, një furnizues energjie elektrike, lidhjet kablore, elementë të pasme ose elementë për tokëzim dhe fiksim, të pikave të aksesit pa tel në zona të vogla janë instaluar veçmas, çdo pjesë e saj që tejkalon 30 litra duhet të jetë e padukshme për publikun e gjerë.</p> <p>d) Pika e aksesit pa tel në zona të vogla duhet të ketë konsistencë vizuale me strukturën mbështetëse dhe të ketë një madhësi proporcionale në lidhje me madhësinë e përgjithshme të strukturës mbështetëse, formë të qëndrueshme, ngjyra neutrale që përputhen ose përziehen me strukturën mbështetëse dhe kabllo e fshihura dhe nuk duhet së bashku me pikat e tjera në zona të vogla pa tel që janë instaluar tashmë në të njëjtin stacion ose në stacionet ngjitur, të krijojnë një pamje të përgjithshme të çrregullt.</p> <p>e) Pështa e një pike aksesit pa tel në zona të vogla dhe forma e saj nuk duhet të imponojnë një përforcim strukturor të strukturë mbështetëse.</p> <p>f) Një pikë aksesit pa tel në zona të vogla të klasës së instalimit E10 (10 W/AT) do të vendoset vetëm në ambiente të jashtme ose në hapësira të mëdha të brendshme, të cilat kanë lartësi tavanit të paktën 4 m.</p>	<p><b>Neni 5</b></p>	<p><b>E Plotë</b></p>
---------------------------------	---	----------------------	---	---	--	----------------------	-----------------------

	<p>specifike e përbihjes (SAR) në afërsi të stacioneve bazë të radiokomunikacionit për qëllimin e vlerësimit të ekspozimit të njeriut". 2. Në rastin e sistemeve të shumëllojshme antenash të bashkëvendosura (ose pjesëve të tyre) të një ose më shumë pikave të aksesit me valë me zonë të vogël që i nënshtrohet kësaj rregullorje, kriteret për EIRP të përfshira në standardin e përmendur në pikën 1 do të zbatohen për shumën e EIRP e të gjitha sistemeve të antenave të bashkëvendosura (ose pjesëve të tyre).</p>			<p>tabelën e seksionit 6.2.4 të standardit SSH EN 62232:2017 për përcaktimin e fuqisë së fushës së radioflekurancave, densitetit të fuqisë dhe SAR në afërsi të stacioneve bazë të radiokomunikacionit për qëllim të vlerësimit të ekspozimit të njeriut.</p> <p>2. Në rastin e sistemeve të shumëllojshme të bashkëvendosura (ose pjesëve të tyre) të një ose më shumë pikave të aksesit pa tel në zona të vogla subjekti i kësaj rregullorje, kriteret për EIRP të përfshira në standardin e përmendur në pikën 1 do të zbatohen për totalin e EIRP-it për të gjitha sistemet e antenave të bashkëvendosura (ose pjesëve të tyre).</p>		
--	---	--	--	--	--	--